



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 38

Datë: 10.07. 2024 ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Fazli Stollaj, Qemal Kurtis, Mufera Shinik.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 37/2024

2. Aktivitetet e Zyrës

1. Rekomandimi për pezullimin e partisë politike GRAĐANSKA INICIJATIVA GORE, me akronimin GIG;
2. Rekomandim për regjistrimin e partisë politike LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS;
3. Rekomandim për privim të përfitimit të mjeteve financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për subjektin politik PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM

3. Raport i Këshillave të KQZ

4.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për asgjësimin/ shkatërrimin e materialit zgjedhor për zgjedhjet e 21 prillit 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i udhëtimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë lidhur me projektin për transparencë zgjedhore.

5. Të ndryshme !

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari **Radoniqi** paraqiti rendin e ditës, ndërsa u miratua agjenda e mbledhjes pa shtesë, propozim, si dhe u miratua procesverbali nr. 37.

2. Aktivitetet e Zyrës

Rekomandimi për pezullimin e partisë politike GRAĐANSKA INICIJATIVA GORE, me akronimin GIG:

Lidhur me aktivitetet e Zyrës, **Basnik Buzhala** drejtor, tha se propozimi për pezullim nga zyra, vjen na fakti se ky subjekt, nuk e ka mbajtur kuvendin. Data 20 1ershor 2024, ka qenë afati i fundit për ta mbajtur kuvendin. Nga rekomandimi ynë, derivon shtytja e KQZ-së që në afat prej 45 ditësh ta mbaj kuvendin.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të Zyrës.

Rekomandim për regjistrimin e partisë politike LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS:

Buzhala, tha në vazhdim se ky subjekt është parlamentar, dhe participin edhe në fondin material mirëpo, ky subjekt është e shtyrë të regjistrohet si parti politike. Ne rekomandojmë që ky subjekt të regjistrohet sepse, nuk është i obliguar të mbledh nënshkrime dhe, mund të regjistrohet si subjekti nr. 53 në regjistrin e partive politike.

Arianit Elshani, anëtar i KQZ-së pyeti nëse ka edhe subjekte tjera që nuk e kanë bërë regjistrimin si subjekt, ndonëse marrin mjete nga buxheti i Kosovës. Buzhala, tha se është ky subjekt që ka aplikuar për regjistrim.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.

Rekomandim për privim të përfitimit të mjeteve financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për subjektin politik PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM:

Në vazhdim z. **Buzhala** tha se Zyra rekomandon që të privohet nga e drejta e përfitimit të mjeteve financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për subjektin politik PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM. Ky subjekt, nuk ka bashkëpunuar as me zyrën dhe as me auditorin ligjor dhe subjekti në fjalë nuk ka bërë pasqyrat financiare. Ne kemi korrespondencat, auditori po ashtu, por subjekti nuk është përgjigjur fare. E njëjta gjetje, është edhe në vitin 2022 dhe këtij subjekti, i është shqiptuar vërejtja. Por subjekti nuk është përgjigjur, dhe nuk ka bashkëpunuar as në vitin 2023.

Sami Kurteshi, tha se KQZ është e detyruar me marrë vendim sepse, ato mjete janë nga buxheti publik, janë donacionet etj. Ky subjekt, e ka një deputet në Parlament. Është një shumë e caktuar e një subjekti të vogël, por injorimi nuk është i kuptueshëm. Pyetja ime është se, a mundeni me i kontaktue, a ka rrugë ligjore që edhe njëherë me komunikue disi dhe me ju dhënë një afat shtesë. A ka mundësi me u kontaktue ata...?

Besnik Buzhala tha se, ata nuk janë përgjigjur dhe, nuk i janë përgjigjur as auditorit!

Diskutuan edhe: Ilir Gashi, Arianit Elshani, Gordana Llaban, Alban Krasniqi, Besnik Buzhala.

Në fund të shqyrtimit tejet të detajuar, anëtarët e KQZ-së votuan me 10 vota për rekomandimin e përfitimit nga fondi i mbështetjes së partive politike.

3. Raport i Këshillave të KQZ

4.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për asgjësimin/ shkatërrimin e materialit zgjedhor për zgjedhjet e 21 prillit 2024:

Arianit Elshani, tha se KOZ ka shqyrtuar raportin për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor për zgjedhjet e 21 prillit 2024. Në kuadër këtij raporti, janë foto e procesit të shkatërrimit. Bëhet fjalë lidhur me votimin që u mbajt në prill, i gjithë materiali që është përdorur në këtë proces votimi. Shkatërrimi i materialeve, bëhet pas certifikimit të rezultateve...

Sami Kurteshi: Nëse janë shkatërrua, janë fshi të gjitha regjistrimet, ato me kamera...?

Arianit Elshani: Po, nga 67 kamera të vendosura, janë fshi të gjitha regjistrimet. Kjo, madje është bërë edhe me vendim. Do të ndodh edhe në proceset tjera. Incizimet nuk ruhen, vetëm kur ka kontest, hetim, gjykim etj.

Raporti, u miratua me 10 vota për...

2. Shqyrtimi dhe miratimi i udhëtimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë lidhur me projektin për transparencë zgjedhore:

Arianit Elshani: E kemi shqyrtuar edhe këtë kërkesë të ardhur nga administrata, KOZ ku është diskutua lidhur me ndryshimet, e që synohet ngritja e transparencës në KQZ, në QNR por edhe në KKZ-të për të gjitha zgjedhjet. E kemi konsideruar të nevojshme një vizitë në Shqipëri, meqë kemi gati një sistem të ngjashëm të menaxhimit të VV dhe gjithë procesit.

KOZ, rekomandon që një numër i Sekretariatit të shkojë në një vizitë pune në Shqipëri. Pjesëmarrja, mbetet të organizohet...

Me 10 për, u miratua një udhëtim zyrtar në Shqipëri.

4. Të ndryshme !

E mbyllur. Nuk është incizuar, deri te ky vazhdim...

Kreshnik Radoniqi: AËEB, na ka dërgua një shkresë ku na ka ftuar të marrim pjesë në vëzhgimin e zgjedhjeve në SHBA. Për të marrë pjesë duhet me u regjistruar. Vizita bëhet me shpenzimet tona. Na është thënë nëse IFES, mundet me na sponsorizuar diçka...

Edhe një ftesë tjetër mbi një konferencë, ju kujtohet kur ishim në Seul, diçka e njëjtë Republika Domenikane do me e organizue...! Me viza, me shpenzime duhet t'i heqim ne...

Sami Kurteshi: Organizata e vendeve Frankofone na ka dërgua një ftesë 24-25 tetor, në Benin. Ata kanë kërkuar me siguri agjendën. Unë, nuk jam i interesuar, por frëngjishtja është gjuha kryesore.

Kreshnik Radoniqi: Në Kolumbi, duhet me marrë pjesë sepse atje është një votimi, ne e kemi të drejtën e votës...